

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik



01

"RINIA NDRYSHON LIGJET" – TURI I KONSULTIMEVE PËR LIGJIN "PËR RININË" DHE "PËR VULLNETARIZMIN" NDALON NË 12 BASHKI

Në kuadër të procesit të rishikimit të Ligjit "Për Rininë" dhe Ligjit "Për Vullnetarizmin", të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 sipas kërkesave të të rinjve gjatë procesit të hartimit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, organizoi një tur të gjerë diskutimesh në 12 bashki të Shqipërisë, duke përfshirë të rinj nga Kurbini, Shkodra, Lushnja, Kuçova, Dibra, Durrësi, Librazhdi, Kamza, Tirana, Tropoja, Konispoli dhe zonat përreth.

Këto takime, të realizuara me kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e Këshillave Vendorë Rinorë, kanë mbledhur ide dhe rekomandime nga të rinjtë për të përmirësuar legjislacionin aktual. Të rinjtë dhanë kontributet e tyre përmes diskutimeve të hapura dhe anketave dhe çdo ide e rekomandim u shënuar për t'u reflektuar në draftligjet që po shqyrtohen.



02

KONFERENCA PËR RISHIKIMIN E LIGJIT 24/2015 "PËR VULLNETARIZMIN"

Në vijim të procesit të rishikimit të Ligjit 24/2015 "Për Vullnetarizmin", Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët organizoi më datë 9 Korrik konferencën për rishikimin e ligjit, ku morën pjesë Ambasadori i Bashkimit Europian në Shqipëri, Zëvendësministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacioni, Drejtori Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Menaxherja e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë dhe për vullnetarizmin si dhe të rinj vullnetarë, të cilët shprehën rekomandimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e kuadrit ligjor.

Kjo konferencë theksoi rritjen e angazhimit shoqëror, profesional dhe shpirtëror të të rinjve si prioritet kryesor, që garantohet duke ndjekur praktikat më të mira europiane për një vullnetarizëm cilësor dhe të qëndrueshëm. Konferenca u organizua në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri, Bashkimin Europian në Shqipëri, Partners Albania for Change and Development, dhe me mbështetjen e pakursyer nga UNICEF dhe World Vision Albania për punën e deritanishme me projektligjin.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
RYEVE-MINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik



03

ÇELET THIRRJA E NËNTË E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

Më datë 8 Korrik, Ministri e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka njoftuar çeljen e Thirrjes së Nëntë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, duke ftuar të gjithë të rinjtë e moshës 21-26 vjeç që të aplikojnë për një praktikë 3-mujore pranë institucioneve të administratës shtetërore. Aplikimet do të jenë të hapura deri më 15 gusht në portalin: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>. **Me mbi 1200 pozicione të lira**, ky program synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar me profesionistë karriere në administratën publike, duke zhvilluar aftësitë e tyre profesionale dhe praktike.

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, aktiv prej 9 vitesh, ofron një mundësi të vyer për të rinjtë që kanë përfunduar minimalisht ciklin e parë të studimeve "Bachelor". **Pas përfundimit të praktikës, pjesëmarrësit pajisen me certifikatë nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Departamenti i Administratës Publike, e njohur si përvojë pune. Të rinjtë e vlerësuar me pikë maksimale gjatë praktikës, do të mund të punësohen me kontratë pune 1-vjeçare bazuar në nevojat e institucionit pritës.**



04

SHKËMBIM RINOR MIDIS SHQIPËRISË DHE KOSOVËS – "TRASHËGIMIA DJE, SOT DHE NESËR"

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të AKR-së dhe Drejtorin e Departamentit të Rinisë pranë MKRS-së së Kosovës, mirëpritën të rinjtë nga Shqipëria dhe Kosova në një shkëmbim kulturor të pasur me njohuri dhe emocione. Ky aktivitet, i organizuar nën moton "Trashëgimia dje, sot dhe nesër," ndërgjegjësoi të rinjtë për rëndësinë e trashëgimisë kulturore si pjesë e identitetit tonë kombëtar.

Gjatë takimit, të rinjtë patën mundësinë të marrin pjesë në diskutime që theksonin rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Ata ndanë përvoja dhe ide, duke krijuar lidhje të reja dhe forcuar ato ekzistuese midis të dyja vendeve. **Aktiviteti përfshiu gjithashtu vizita në vende historike dhe kulturore në Shqipëri si Kalaja e Ishmit dhe Amfiteatri i lashtë i qytetit të Durrësit, duke i dhënë të rinjve një përvojë të gjallë dhe të prekshme të historisë dhe traditave të tyre. Ky shkëmbim kulturor jo vetëm që forcoi marrëdhëniet ndërmjet të rinjve të Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe i pajisi ata me një njohuri më të thellë dhe respekt për trashëgiminë e përbashkët kulturore.**



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik



05

PROJEKTI I PËRBASHKËT PËR TË RINJTË MIDIS BULLGARISË DHE SHQIPËRISË

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti delegacionin e Bullgarisë, drejtuar nga Zëvendës Ministri Petar Mladenov, mbi **implementimin e projektit të përbashkët për përmirësimin e kapaciteteve administrative të punës në lidhje me politikat rinore dhe procesin e integritit në BE.**

Takimi u karakterizua nga një shkëmbim i frytshëm eksperiencash dhe praktikash të mira në fushën e rinisë, ku pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe ndërtimin e urave të reja lidhëse që nxisin fuqizimin e të rinjve. Diskutimet u përqendruan në mënyrat konkrete se si mund të avancohen politikat rinore dhe të përmirësohet pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendimmarrëse. **Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve administrative dhe përgatitjen për një integrim të suksesshëm në BE.**



06

TRYEZA E RRUMBULLAKËT E UNDP PËR RITJEN E EFIÇENCËS DHE TRANSPARENCËS NË PËRKRAHJEN E ORGANIZTAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga UNDP Albania, së bashku me aktorët kryesorë të ReLOaD2, përfaqësues të Delegacionit të BE-së, pushtetit vendor, dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC). Kjo tryezë kishte për qëllim zhvillimin e një dialogu gjithëpërfshirës për rritjen e efiçencës dhe transparencës në përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile përmes fondeve publike dhe donatorëve.

Përgjatë diskutimeve, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ndau me të pranishmit eksperiencën e bashkëpunimeve të shumta të suksesshme me UNDP dhe ekipin ReLOaD2, veçanërisht në kuadër të implementimit të metodologjisë LOD nga Agjencia Kombëtare për Rininë për shpërndarjen e granteve për OSHC dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo metodologji ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe efiçencës në shpërndarjen e fondeve publike, duke kontribuar gjithashtu në zhvillimin e kapaciteteve të stafeve që ndjekin ciklin e thirrjeve dhe monitorimin e projekteve për rininë. Tryeza shënoi një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të praktikave të financimit dhe rritjes së mbështetjes për sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RYEVE MINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Korrik



07

PROMOVIMI I INOVACIONIT DHE TEKNOLOGJISË PËR SHËNDETIN MENDOR TË TË RINJVE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët iu bashkua aktivitetit "Upshift për shëndetin mendor dhe mirëqenien" në Elbasan, duke mbledhur miq, kolegë dhe mbështetës të programit për të reflektuar së bashku mbi impaktin e tij te të rinjtë. Gjatë diskutimeve me ekspertë nga fusha e inovacionit, teknologjisë, edukimit dhe rinisë, u theksua rëndësia e përdorimit të teknologjisë pa humbur ndërveprimin social dhe mënyrat për të arritur të rinjtë kudo ku ndodhen, me mbështetjen e institucioneve, sektorit privat, akademisë dhe të rinjve vetë.

Aktiviteti u zhvillua në shkollën profesionale "Salih Ceka" të Elbasanit, ku 11 grupe të rinjsh me ide që adresojnë çështjet e shëndetit mendor u bënë pjesë e këtij edicioni të Upshift. Nga këto, tre grupe u kurorëzuan fitues dhe do të kenë mundësi të realizojnë idetë e tyre me mbështetjen e fondit të Upshift. **Ky aktivitet shërben si një platformë për të rinjtë për të zhvilluar ide inovative dhe për të përmirësuar mirëqenien e tyre mendore, ndërkohë që shkollat profesionale dhe orientimi i të rinjve drejt tregut të punës mbeten një prioritet i qeverisë për rritjen e punësimit dhe përgatitjen e fuqisë punëtore korrikore. Ministri gjithashtu inkurajoi të rinjtë të aplikojnë për regjistrimin në shkollat e mesme profesionale përmes portait e-Albania, me aplikimet të hapura deri më 30 shtator.**



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT